KËRKESË
Nr. 91/7, datë 27.2.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i 'Rigjenerimi urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Skrapar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "ndërtesë" bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit "ndërtesë banimi ose jo banimi", i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Skrapar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 643,857 (gjashtëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIGJENERIMI URBAN I ZONËS AFËR GJIMNAZIT NË RRUGËN E DËSHMORËVE, ÇOROVODË"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE										"NDËRTESË"			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Are" (m^2)	"Truall" (m^2)	"Ndërtesë" (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	Ç	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	R	S	T	Y	Z
1	Batjar	Ibrahim	Laze	Çorovodë	1420	11/51	Njësi	18			18	9	37	18	35770	643857	643857	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA																	643857	